

“E DREJTA PENALE EVROPIANE SI KOMPONENT JURIDIK I RENDIT EVROPIAN”

ALTIN SHEGANI

KORRIK 2023

ELBASAN

KOORDINATAT E HARMONIZIMIT TË SË DREJTËS PENALE MATERIALE SHQIPTARE ME TË DREJTËN PENALE EVROPIANE

Harmonizimi i legjislacionit penal me aktet e Bashkimit Evropian në fushën e terrorizmit; Direktiva 541/2017/BE “Mbi luftën kundër terrorizmit. Risite:

- 1. Faktet; n. 230-234/b KP: veprat me qëllim përhapje paniku, detyrimin e inst për veprime të caktuara për të shkatteruar apo destabilizuar strukturat shtetërore, ekonomike, politike, sociale të çdo shteti.*
- 2. Qëllimi;*
- 3. Vepra që lidhen ngushtësisht me terrorizmin (financimi i terrorizmit n. 4 D dhe n. 230/a KP, fshehja n. 230/b);*
- 4. Nxitja n. 232/a KP;*
- 5. Rekrutimi n. 231 KP;*
- 6. “Luftetaret e huaj”, n. 265/a KP: “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj.” (N. 7 i KP; juridiksioni universal), efikasiteti i politikës penale vs terrorizmit*

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT PENAL ME AKTET E BASHKIMIT EVROPIAN NË FUSHËN E KORRUPSIONIT NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT; DIREKTIVA 1371/2017/BE “PËR LUFTËN KUNDËR MASHTRIMIT TË INTERESAVE FINANCIAR NË BASHKIMIN EVROPIAN”; VENDIMI KUADËR 568/2003/KE

Kerkimet:

1. Unifikimi I termit “funksionar publik”; (L. 152/2013 “Per nepunesin civil”)
2. Unifikim I politikes penale per masat e denimit – demi I ardhur;
3. Figure e posacme: nxitja (jo vetem bashkepunim);

“Nxitja për korrupsion” me këtë përmbajtje:

“Nxitja që i bëhet një funksionari publik për të kryer një nga veprat penale me natyrë korruptive, përveç rastit kur vepra konsiderohet e kryer në bashkëpunim, dënohet deri x vjet burgim”.

4. Shperblimi I demit. Identifikimi I veshtire I pasurise object sekuestrimi.

KORRUPSIONI NË SEKTORIN PRIVAT

Neni 164/a, 164/b KP;

Subjektet: shoqerite tregtare dhe OJF;

Kodi Penal nuk parashikon si fakte penale “*nxitjen*” dhe “*ndihmën*”

Sipas vendimit kuadër, këto fakte duhet të dënohen minimalisht 1 deri në 3 vjet ndërkohë që referuar përmbajtjes së dispozitave të Kodit Penal, këto fakte në minimum dënohen më pak se 1 vit.

**HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT PENAL NË FUSHËN E TREGJEVE FINANCIARE; DIREKTIVA 6/2003/KE,
PËRMIRËSUAR ME DIREKTIVËN 26/2008/KE DHE DIREKTIVËN 78/2010 TË PARLAMENTIT
EVROPIAN DHE KËSHILLIT EVROPIAN “KUNDËR ABUZIMIT ME INFORMACIONIN E PRIVILEGJUAR DHE
MANIPULIMIN E TREGJEVE”**

Tregjeve të përbashkëta nga ana e vendeve të unionit në kuadër të
“qarkullimit të lirë të mallrave dhe shërbimeve”;

Risi: “*Informacion i privilegjuar*”: info. Sakte, papublikuar lidhur me
instrumentat financiare ,

“*manipulim tregu*”: transaksione mashtruese lidhur me kërkesën, ofertën ose
cmimin e instrumenteve financiare

Rekomandimi:

Perkufizimi I “*Informacion i privilegjuar*”;

Te parashikohet si kryerje ne rrethana cilesuese lidhja me aktet terroriste.

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË FUSHËN E PASTRIMIT TË PARAVE; DIREKTIVA
_849/2015/BE “MBI PARANDALIMIN E PËRDORIMIT TË SISTEMIT FINANCIAR PËR QËLLIME TË
PASTRIMIT TË PARAVE APO FINANÇIMIN E TERRORIZMIT”

Risite:

1. Juridiksioni universal;
2. Provueshmeria e Vepres penale baze, autori I saj, shteti;
3. Funksonari public si autor;
4. Format tipike te vp;
5. Fajesia: “pakujdesi e rende”, vetebesim i tepruar;

Rekomandime:

1. n. 7/a Juridiksioni universal;
2. N. 287 KP ne prg 4 te shtohet: “Dispozitat e ketij neni zbatohen edhe kur autori I I vepres penale nuk njihet”;
3. N. 287/b KP te ndryshohet forma e fajesise nga: “...**Duke ditur se një person tjetër ka përfituar...**” ne: “... **Në kushtet ku duhej të dinte se një person tjetër...**”.

HARMONIZIMI I KODIT PENAL ME AKTET E BASHKIMIT EVROPIAN LIDHUR ME INSTITUTIN E “LIRIMIT ME KUSHT”

Rec 2003(22) I Komitetit te Ministrave te ShA:

“Nuk ka prezumim absolut per rrezikshmerine e theksuar shoqerore deri ne fund te jetes”.

Kushtet per plotesim; trajnim institucional per lirimin.

N. 64, 65 KP. Mungon harmonizimi plotesisht:

1. Qellimi jo rehabilitimi por ndeshkimi;
2. Fuqia e rekomandimit si instrument juridik;

Rekomandimi:

1. Rishikim I ligjit;
2. Gjykim incidental.

MBI PARIMIN “NE BIS IN IDEM” SIPAS TË DREJTËS PROCEDURIALE PENALE EVROPIANE

Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 4 i Protokollit nr. 7:

Askush nuk mund të ndiqet, ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit shtet për një vepër penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm, ose ka qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti.

Neni 54 i Konventës për Zbatimin e Marrëveshjes Shengen

Direktiva 2003/6/KE: zgjedhja midis denimit adm apo penal

Neni 42 Kushtetutes se RSH:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

N. 7 KPrP:

«Askush nuk mund të gjykohet **rishtas** për të njëjtin fakt penal, për të cilin është gjykuar me **vendim të formë së prerë**, me përjashtim të rasteve kur është vendosur **rigjykimi** i çështjes nga gjykata kompetente»;

GjEDNj: ceshtja “**Gözütok dhe Brügge**“, “**Nykanen kundër Finlandës**” (gjykimi adm);

Cështja “**Spector Photo Group**” (gjykimi adm)

GjED: ceshtja “**Kosovski**”

VU KBGjL nr 2 datë 03.11.2014 dhe GJ Kushtetuese (Vendim nr.24, datë 12.11.2008): **«vendim i formës së prerë»**; **«vendim i ekzekutueshëm»**; **«gjësë së gjykuar»**

V. 4158/2018 e Gj. Adm. Shkalles Pare Tirane;

V. 687/2018 Gj.Penale Shkalles Pare (n.291 KP); V. 80-2018-1906/2018 Gj. Adm. Shkalles Pare Tirane (L.Drejtimi);

Rekomandim:

Riformulim:

“Askush nuk mund të gjykohet serish për të njëjtin fakt penal, për të cilin është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rishikimi i çështjes nga gjykata kompetente.

Askush nuk mund të gjykohet serish për të njëjtin fakt, nese nga prokurori eshte vendosur arkivimi i çështjes penale. Vendimi i prokurorit të një shteti tjetër për pushimin e çështjes penale zbatohet vetëm kur janë respektuar parimet e reciprocitetit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike.

Askush nuk mund të gjykohet serish për të njëjtin fakt edhe në rastin kur ndaj tij per te njejtin fakt me pare eshte dhene nje denim administrative me natyre penale dhe jo vetem zhdemtuese.”

VESHTRIM KUSHTETUES DHE KRAHASUES TE NENEVE 290 DHE 291 TE KP NE KUADER TE “GJESE SE GJYKUAR”

Objekti: marrëdhëniet juridike të vendosura me qëllim ruajtjen dhe garantimin e rregullave të qarkullimit rrugor si dhe mbrotjen e jetës dhe shëndetit të përdoruesëve të rrugës.

Neni 291 është pjesërisht në kundërshtim me parimin kushtetues të gjëse së gjykuar në pjesën ku nuk parashikon *“pa zbatueshmërinë e saj në eventualitetin e zbatimit të nenit 290 të kodit penal”*.

Neni 291 Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt

Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet. Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit

Neni 290 Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.

ASPEKTE KRAHASUESE TË POZITES JURISPRUDENCIALE TË GJEDNJ-SË NË
PRAKTIKËN GJYQËSORE SHQIPTARE MBI PROCESIN E RREGULLT LIGJOR

Kontradiktorialiteti dhe leximet e lejueshme në procesin penal si element i procesit të rregullt ligjor;

Pyetja e dëshmitarit me identitet të rremë;

Pema (prova) e helmuar;

E drejta për të heshtur (mosinkriminuar);

E drejta për jetë private dhe/ose familjare, kontrolli i banesës.

KONTRADIKTORIALITETI DHE LEXIMET E LEJUESHME PYETJA E DËSHMITARIT ME IDENTITET TË RREMË

GJEDNJ: “Schatschaschwili kundër Gjermanisë” dhe “Al Khawaja kunder Britanise”

Nenin 6 paragrafi 1 dhe 3 (d) i KEDNJ: “Drejtësi procedurale”

“Kontradiktorialiteti në procesin penal” (cross examination)

Aktet e mbledhura në fazën e hetimit mund të pranohen “inter alia” në shqyrtimin gjyqësor, kur për shkaqe objektive rimarrja e tyre në gjykimin në themel nuk mund të bëhet.

Kushtet:

1. Arsye e forte për pranimin e deklaratës së dëshmitarit në mungesë;
2. E vetmja bazë dhe vendimtare për fajësinë;
3. Faktore të mjaftueshëm kundërbalancues për një proces të drejtë në tërësi.

N. 369/3 KP jo i harmonizuar plotësisht:

“Leximi i deklaratave të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur ose kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzon të dëshmojë”.

Si duhet:

Leximi i deklaratave të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur dhe kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore ose/dhe pas ezaurimit të rrugës së ndërsjelltë juridike si dhe kur refuzon të dëshmojë, me kusht që pamundësia e tij për të qënë në proces të mos ketë qënë e parashikueshme”.

PYETJA E DËSHMITARIT ME IDENTITET TË RREMË

Neni 165/a i K.Pr.P (risi ligjore -2017)

GjEDNj: Rregulli I pergjithshem: *E drejta per te njohur provat dhe kundershtuar;*

Perjashtimi: kur cenohet siguria e deshmitarit

Deshmia vjen me mekanizma te tjere duke krijuar nje process te balancuar midis interesave te dy paleve

Konsiderohet se eshte arritur harmonizim I plote ligjor.

PEMA (PROVA) HELMUAR

N. 6 I KEDNj: Procesi i rregullt gjyqesor:

Rregulli I pergjithshem: **Prova e helmuar si prove e marre ne kundersiztim me proceduren ligjore. Cdo prove qe rrjedh prej saj gjithashtu e pavlefshme.**

GjEDNj: Perjashtimi: **Ne mungese te proves se helmuar nuk do te gjendeshin provat qe vertetojne aktin penal.** Ceshtjet: *Schenk kundër Zvicrës, Teixeira de Castro kundër Portugalisë, Heglas kundër Republikës Çeke etj.*

N.151/3 KP dhe Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr 180/2013:

“Askush nuk mund të dënohet mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme”.

Rekomandim:

“Provat e tjera të zbuluara si rezultat i drejtëpërdrejtë i një prove të paligjshme nuk mund të përdoren në procesin gjyqësor përveç rastit kur ato pavarësisht faktit se rrjedhin nga një provë e paligjshme gjithsesi do të ishin zbuluar”; ose

“Vendimi i gjykatës që mbështetet në prova të parrgullta nuk shpallet i pavlefshëm nëse vendimi do të ishte i njëjtë edhe në mungesë të provave të paligjshme çmuar në vendimin përfundimtar”.

E DREJTA PËR TË HESHTUR (MOSINKRIMINUAR)

Origjina: sistemi common law.

Raportet e Gjykatës Supreme të Kanadase 1990, 2:151:

“Mjafton që në kontekstin e bisedës, i arrestuari të mos jetë nxitur me qëllim përftimin e deklaratave. “

Konfirmimi: GjEDNj: ceshtja “Allan vs Frances”:

Roli aktiv I agjentit te infiltruar dhe ana subjektive e te pandehurit lidhur me riskun.

Rasti I Shqiperise: Haset shpesh ne praktike por nuk eshte e rregulluar ligjerisht.

Neni 222 KPrP te shtoje nje prg.:

“Përgjimi dhe rezultatet e përgjimit të ndodhur në ambientet e paraburgimit ose të izolimit nuk mund të përdoren nëse i ndaluarit ose i arrestuari është shtyrë nga një bashkëpunëtor i policisë ose prokurorisë, përveç rastit kur bashkëpunëtori ka luajtur rol pasiv dhe thëniet e të ndaluarit ose të arrestuarit kanë qënë spontane ose rastësore të shprehura me vullnetin e tij të lirë”.

KONTROLLI I BANESES, PERSONIT DHE VENDEVE PER PROVA MATERIAL APO SENDE TE VP

KEDNj, N. 8 ; GjEDNj: “*Lambert kundër Francës*”: kontrolli i banesës duhet të kryhet në kushte rigorozisht të përcaktuara me vendim gjykate

N. 202, 202/a KP (2017): parashikon kontrollin e banesës me vendim gjykate.

KP është bazuar në formulimin e KP Italian, GjEDNJ e ka gjetur në shkelje Itالية: “*Brazzi kundër Italisë*”: nuk parashikohet kontrolli *ex post* nga gjykata.

KP Shqiptar jo i harmonizuar me ligjin evropian.

Rekomandim:

N. 298 KP si neni ku referon n. 202:

“Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara.

Duhet:

“Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, kërkon nga gjykata vleftësimin e kontrollit dhe të sendeve të sekuestruara si të ligjshme. Brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës gjykata vendos sipas rastit vleftësimin e kontrollit dhe të sendeve të sekuestruara”.

HARMONIZIMI I MBROJTJES JURIDIKE ME NORMATIVËN PENALE EVROPIANE PËR TË MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN SI AUTOR I VEPRAVE PENALE

Program dedikuar drejtesise penale per te mitur te quajtur Road Map 2009 te perbere nga disa Direktiva:

Direktiva 2010/64/BE; Direktiva 2012/13/BE; Direktivën 2013/48/BE; Direktiva nr. 2016/800/BE.

Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” (KDF)-korniza ligjore penale per te mitur me synim personalittin dhe jo faktin.

Direktiva (BE) 2016/800 “Mbi garancitë procedurale për të miturit nën hetim ose të pandehur në procedurat penale”:

Garancitë proceduralë në rastin e kufizimit të lirisë;

E drejta e të miturit në konflikt me ligjin për t’u shoqëruar nga “prindi” “kujdestari ligjor” ose një “person tjetër i besueshëm” dhe e drejta e pjesëmarrjes në gjykim.

E drejta e të miturit nën hetim apo i akuzuar për të mos ju nënshtruar procedurave diskriminuese;

Parimi i interesit më të lartë të të miturit në procesin penal

LIGJI PENAL SHQIPTAR KONSIDEROHET I HARMONIZUAR.

Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm shqiptar me Direktivën 2010/64/BE “Mbi të drejtën e intepretimit dhe përkthimit në procedimet penale”.

KDF nuk parashikon të drejtën e të miturit **për përkthimin e dokumenteve apo akteve procedurale që janë thelbësore për procesin** apo procedimin penal;

b. Nuk përcaktohet me dispozitë të posaçme, ashtu siç direktiva ka parashikuar, se **cilat duhet të konsiderohen akte thelbësore në procesin penal**;

c. **Nuk parashikohet detyrimi i përkthyesit/ interpretuesit të ruajë privatësinë dhe sekretin e të dhënave të zbuluara si rrjedhojë e detyrës**;

d. Nuk parashikohet një kuadër ligjor, i cili mundëson **ankim kundër vendimit të autoritetit procedues që nuk pranon kërkesën për përkthim si dhe kundër përkthimeve të cilat nuk janë të përshtatshme dhe profesionale**, për të cilat rekomandohen ndryshime konkrete në K.D.F dhe Kodin e Procedurës Penale.

Së pari: nuk përmban dispozita të detajuara të cilat të parashikojnë të drejtën e të miturit për t'u asistuar nga një mbrojtës gjatë procedurave që zhvillohen në ngarkim të tij, por mjaftohet me parashikimin e “të drejtës për të pasur mbrojtës”.

Së dyti: nuk përcakton situata faktike në të cilat prezenca e mbrojtësit është e detyrueshme dhe se shpenzimet mbulohen nga shteti. Madje ligjvënësi ka shkuar në një situatë juridike “*in absurdum*” pasi parashikon të drejtën e të miturit të dënuar për t'u paisur me mbrojtës në rastin kur shqyrtohen masat disiplinore si rrjedhojë e shkeljeve të rregulloreve të IEVP së bashku me modalitetet dhe garancitë shtesë, dhe nuk parashikon të drejtën e tij kur bëhet fjalë për kyerjen e veprave penale.

Së treti: K.D.F nuk përmban asnjë normë të posaçme lidhur me të drejtat që i mituri në konflikt me ligjin ka mbi ruajtjen e komunikimeve me avokatin e tij.

DIREKTIVËN 2010/64/BE “MBI TË DREJTËN E INTEPRETIMIT DHE PËRKTHIMIT NË PROCEDIMET PENALE”.

Risi: dy koncepte me rëndësi, si “e drejta për intepretim” dhe “e drejta për përkthim”.

Neni 19/3 KDF:

“Në çdo fazë të procedimit penal, i mituri gëzon të drejtën për një përkthyes falas/ interpretues, në qoftë se nuk e kupton, nuk e flet gjuhën që përdoret ose përdor gjuhën e shenjave’.

neni 50 parashikon se:

“E drejta e të miturit për të komunikuar në gjuhën që kupton.

Nëse i mituri nuk e kupton, nuk e kupton pjesërisht ose plotësisht si duhet ose nuk mund të flasë gjuhën me të cilën procedohet, atij i caktohet një përkthyes pa pagesë, i cili duhet të jetë i pranishëm në çdo veprim procedural. Nga ky rregull bëhet përjashtim vetëm në rastet kur veprimet ose/dhe mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe në rastet e parashikuara lidhur me flagrancën, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale....

Në raport me direktivën, KDF duket sikur e kufizon të drejtën e përkthimit vetëm në kuadër të intepretim verbal

DIREKTIVËN 2011/93/EU, OJ 2011 L “MBI LUFTEN KUNDER SHFRYTEZIMIT DHE ABUZIMIT SEKSUAL TE FEMIJEVE DHE PORNOGRAFINE E FEMIJEVE”.

Mungesa e harmonizimit:

1. Kodi Penal Shqiptar, dhe konkretisht neni 117 i tij, nuk mbulon aktet seksuale të cilat në dukje kryhen apo zhvillohen në prezencën e të miturit;
2. Nuk parashikohen “aktet” apo “materialit pornografik” që duket sikur kryhet nga të mitur, megjithëse në realitet nuk janë të tillë;
3. Paragrafi i fundit i nenit 117 të K.Penal nuk parashikon bi

drejtës së përkthimit të akteve apo dokumenteve. Mbi këtë çështje KDF nuk përmban asnjë dispozitë të posaçme, duke bërë që edhe për të miturit në konflikt me ligjin, njëjtë si në rastin e të rriturve të zbatohen *'inter alia'* dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, e cila në tërësinë e saj nuk mbulon garancitë e direktivës në shqyrtim. Për këtë motiv, kërkohet një ndërhyrje në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, në të cilin të parashikohet shprehimisht:

E drejta e të miturit për përkthimin e dokumenteve apo akteve procedurale që janë thelbësore për procesin apo procedimin penal;

Të përcaktohet me dispozitë të posaçme, ashtu siç direktiva ka parashikuar, se cilat duhet të konsiderohen akte thelbësore në procesin penal;

Detyrimin e përkthyesit/interpretuesit të ruajë privatësinë dhe sekretin e të dhënave të zbuluara si rrjedhojë e detyrës;

Kuadri ligjor, i cili mundëson ankim kundër vendimit të autoritetit procedues që nuk pranon kërkesën për përkthim si dhe kundër përkthimeve të cilat nuk janë të përshtatshme dhe profesionale.

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT TË BRENDSHËM SHQIPTAR ME DIREKTIVËN 48/2013/BE "MBI TË DREJTËN E PASJES SË NJË MBROJTËSI NË PROCEDIMIN PENAL" DHE DIREKTIVËN 2016/343/BE "MBI PREZUMIMIN E PAFAJËSISË".

KDF por edhe K.Pr.P nuk ka parashikuar në mënyrë të plotë garancitë e të miturit në funksion të një mbrojtje efektive:

Nuk përcakton situata faktike në të cilat prezenca e mbrojtësit është e detyrueshme dhe se shpenzimet mbulohen nga shteti;

K.D.F nuk përmban asnjë normë të posaçme lidhur me të drejtat që i mituri në konflikt me ligjin ka mbi ruajtjen e komunikimeve me avokatin e tij.

Këto boshllëqe të K.D.F mundohet t'i zgjidhë Kodi i Procedurës Penale, por jo në mënyrë të plotë. Neni 35 i K.Pr.P.

Neni 9 të KDF : *"Çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

Çdo dyshim për akuzën ndaj të miturit çmohet në favor të tij."

neni 92 i KDF:*"1.Gjatë procedurës së hetimit dhe gjykimit i mituri i pandehur nuk mund të detyrohet të bëjë deklaratime që tregojnë vetëpërgjegjësi penale.*

2. Heshtja e të miturit gjatë procedurës së hetimit dhe gjykimit nuk mund të konsiderohet si pranim i fajësisë.

3. Në rast se i mituri pranon fajësinë, gjykata, në çdo rast, duhet të sigurohet që kjo nuk ndodh për shkaqe që lidhen me moshën, zhvillimin dhe aftësinë e të miturit për të perceptuar dhe kuptuar frikën e një dënimi të mundshëm ose frikën prej tejzgjatjes së kohës së marrjes në pyetje.

HARMONIZIMI I MBROJTJES JURIDIKE ME NORMATIVËN PENALE EVROPIANE PËR TË MITURIN SI VIKTIMË TË VEPRAVE PENALE

Direktivën 2011/93/BE “Për luftën kundër abuzimit dhe shfytëzimit seksual të të miturve si dhe pornografisë me të mitur”.

Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr 1007 datë 30.06.2017:

I pandehuri F.G. akuzohete për E mitura nën 14 vjeç F.G. kallezon babain e saj për veprën penale “Marrdhenieve seksuale me persona në gjini ose kujdestari “ n. 106 KP

E mitura ka kallezuar se ka kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj.

Vendimi është në zbatim të gabuar të ligjit penal material si dhe nuk është në frymën direktivës së BE objekt shqyrtimi .

Prokuroria por edhe Gjykata, me vendimin përfundimtar duhet ta klasifikonin faktin si marrëdhënie seksuale me dhunë me persona të mitur që kanë mbushur moshën 14 vjeç dhe jo marrëdhënie seksuale me persona në gjini për keto arsye:

Së pari: norma në fjalë synon të mbrojë vlerat e familjes dhe jo paprekshmërinë seksuale të të miturve;

Së dyti: vepra penale e parashikuar nga neni 106 është vepër penale “konsensusi” sipas të cilës duhen dënuar të dy subjektet. Mungesa e konsensusit tregon kryerjen e marrëdhënies seksuale pa pëlqimin e njërit subjekt, fakt që determinon ekzistencën e marrëdhënies seksuale me dhunë;

Së treti, çka përbën argument me rëndësi, është që neni 106 i Kodit Penal hyn në kategorinë e veprave penale që ndiqen me ankim të viktimës sipas përcaktimeve të neni 284 të K.Pr.Penale.

Nisur nga argumenti numër 3, në rrugë logjike pyetja që ngrihet është “Nëse një e mitur që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç ose që ka arritur moshën e konsentit seksual dhunohet seksualisht nga një familjar, heq dorë nga ndjekja penale sipas përcaktimeve të nenit 284 të K.Pr.Penale” si duhet të disponojë organi i Prokurorisë dhe Gjykata?

Dhuna seksuale ndaj një të mituri, sidomos kur subjektet ndodhen në marrëdhënie familjare nuk mund të jenë objekt i heqjes dorë, në kushtet kur direktiva e mësipërme kërkon që ndjekja penale të ushtrohet pavarësisht vullnetit të viktimës. (N. 15 Direktives)

KP:

- “kur autori veprës penale është dënuar më parë për të njëjtën vepër penale” parashikohet jo si rrethane cilesuese, por konsiderohet si renduese. Me qellim forcimin e ligjit penal, duhet të parashikohet si rrethane cilesuese.

- Denime plotesuese me të zgjatura në kohë për autorët me veprimtari profesionale;
- në kuadër të përgjegjësisë penale të personit juridik, legjislacioni ynë i brendshëm është i harmonizuar dhe konform direktivës në shqyrtim;
- K.Pr.Penale është i harmonizuar me qëndrimin e direktivës pasi ligjvënësi, referuar neneve 59 të K.Pr.Penale dhe 284 nuk ka përfshirë në kategorinë e veprave penale që nuk ndiqen kryesisht nga organi i prokurorisë veprat me natyrë seksuale kur viktimë e saj është i mituri;
- Parashkrimi. Rekomandim:

“Për veprat penale të parashikuara nga neni 100 dhe 101 i Kodit Penal zbatohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin **por në çdo rast jo më herët se 1 vit pas bërjes së të miturit madhor**”.

KONKLUZIONE

1. E Drejta Penale Evropiane eshte nje e drejte e detajuar si per nga faktet penale ashtu edhe per sa l perket perkufizimeve dhe shpjegimeve te tyre;
2. DPE eshte e drejte dinamike dhe ne evoluim cka kerkon vemendje te vazhdueshme nga studiuesit e cdo shteti, perfshi Shqiperine;
3. Shqiperia nepermjet ligjit te saj penal dhe reformave tenton drejt harmonizimit ligjor me aktet normative dhe jurisprudencen e BE;
4. Nevojitet studim l thelluar l direktivave dhe jurisprudences para cdo ndryshimi ne ligjin penal ne fushen perkatese;
5. Vemendja duhet kushtuar te shpjegimi l fakteve dhe termave me qellim aplikimin e politikës penale efikase;
6. Duhet shtuar figura te posacme te veprave penale si dhe rrethana cilesuese;
7. Duhet shmangur dispozitat referuese;
8. Dispozitat penale duhet te jene me te sakta dhe konkrete ne menyre qe te kuptohen drejt e te zbatohen me eficene pa cenuar te drejtat e paleve ne pocesin penal;
9. Gjykatat dhe organet hetimore duhet te trajtohen drejt njohjes dhe zbatimit te ligjit dhe jurisprudences evropiane;
10. Nevojitet nje Kod l Ri Penal dhe Procedural Penal!